



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4076/11 Prot.

Tiranë, më 24.11.2020

Lënda: *Kërkesë për informacion dhe azhurnimin e të dhënave për hedhjen e shorit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (2021).*

Drejtuar: **ZONJËS NAUREDA LLAGAMI**
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
ZOTIT GENT IBRAHIMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Për dijeni: **ZONJËS ERINDA BALLANCA**
AVOKAT I POPULLIT

Tiranë

Të nderuar,

Së pari, ju falënderojmë për bashkëpunimin midis institucioneve përgjatë procesit të vitit të shkuar për zgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Tashmë është bërë njoftimi publik se, Institucioni i Presidentit të Republikës ka filluar përgatitjen dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm për të bërë të mundur hedhjen e shortit për zgjedhjen e KED (2021) në përputhje me kushtetutën dhe ligjin nr. 115/20216.

Siç dhe jeni në dijeni:

-Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. 5811 prot., datë 13.11.2020 “*Dërgimi i listës me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatave të Apelit dhe të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj, për t’u përfshirë në shortin për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi*”, ka përcjellë tek Presidenti dhe Kuvendi listat e kandidatëve.

-Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresën nr. 1634 prot., datë 16.11.2020 “*Dërgohet lista e prokurorëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtar i Këshillit të Emërimeve për Drejtësi*”, ka përcjellë tek Presidenti dhe Kuvendi listat e kandidatëve.

Në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar në nenin 221, konkretisht në pikat 1-6, përveç të tjerave, përcaktohet se:

“Neni 221

Kushtet dhe kriteret për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe procedurat e përzgjedhjes

1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, **të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:**

a) ***në kohën e hedhjes së shortit*** magistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka ushtruar funksionin e magistratit për të paktën 10 vjet;

b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;

c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;

ç) shfuqizuar

d) shfuqizuar.

dh) magistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, **nëse janë të disponueshme;**

e) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese **nuk është nën hetim** ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

2. Kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti.

3. Jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.

4. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

5. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.

Referuar dispozitave të pikës 1 dhe 2 të nenit 221 të sipërcituar rezulton se, mund të përfshihen në short vetëm ata kandidatë të cilët deri në **momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij neni.**

Në këtë mënyrë është e nevojshme dhe e detyrueshme shkëmbimi i informacionit midis institucioneve tona deri në momentin e hedhjes së shortit, përcaktuar nga Presidenti i Republikës për t’u zhvilluar në datë 4 dhjetor 2020 ora 11:00.

Duke qenë se plotësimi i kushteve dhe kriterëve të ligjit për kandidatët e përfshirë në listë për hedhjen e shortit për anëtarët e KED-së është detyrim që duhet të përmbushet deri në momentin

e organizimit të shortit (datë 4 dhjetor 2020), kërkojmë nga ana institucionet tuaja, bashkëpunim për dhënien dhe azhornimin e informacionit për sa më poshtë:

- A.** Në zbatim të parashikimeve të pikës 1 dhe 2 të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar kërkojmë nga ana e KLGJ-së dhe KLP-së verifikimin në vijimësi të plotësimit të kushteve dhe kriterëve nga gjyqtarët prokurorët e përfshirë në listën e dërguar nga ana e KLGJ-së me shkresën nr. 5811 prot., datë 13.11.2020 dhe listën e KLP-së përcjellë me shkresën nr. 1634 prot., datë 16.11.2020, deri në momentin e organizimit të shortit dhe dërgimin menjëherë të çdo të dhëne apo informacioni zyrtar. Kjo në mënyrë që në momentin e organizimit të shortit në datë 4 dhjetor 2020 të përfshihen në short ata kandidatë gjyqtarë dhe prokurorë që plotësojnë ende kushtet dhe kriteret ligjore.
- B.** Në kushtet kur, kjo dispozitë (neni 221) saktëson kriteret dhe procedurat e aplikueshme nga institucionet tuaja për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që më pas i paraqesin ato pranë Presidentit të Republikës, në mbështetje të nenit 92 germa “h)” të Kushtetutës, kërkojmë gjithashtu që së bashku me azhornimin e të dhënave sa më sipër, të informohemi nga ana juaj nëse:
1. Janë bërë publike nëpërmjet faqes zyrtare të institucioneve që ju drejtoni lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të KED-së dhe lista e kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte, dhe nëse ka patur ankesa pranë Gjykatës Administrative të Apelit për vendimin e marrë nga institucioni juaj nga ana e gjyqtarëve/prokurorëve të cilët janë përjashtuar nga kandidimi?
 2. Ka vendime përfundimtare dhe të formës së prerë nga Gjykata Administrative e Apelit për ankimet e kandidatëve të përjashtuar nga institucioni juaj, për anëtar të KED-së?

Me qëllim përzgjedhjen e rregullt dhe sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të përbërjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, kërkojmë që informacioni mbi procedurat e ndjekura nga institucionet që ju drejtoni të përcillet në një kohë të shpejtë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe për dijeni Avokatit të Popullit, si organ monitorues i procesit të përzgjedhjes me short të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Duke qenë se plotësimi i kushteve dhe kriterëve të ligjit për kandidatët e përfshirë në listë për hedhjen e shortit për anëtarët e KED-së është një detyrim që duhet të përmbushet deri në momentin e organizimit të shortit (datë 4 dhjetor 2020), Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 92 germa “h)” e Kushtetutës dhe nenit 221, të ligjit nr. 115/2016 i ndryshuar, kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë që të informohet me të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të azhornuar që ka të bëjë me listat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të dërguara nga institucionet tuaja, me qëllim që në short të përfshihen ata kandidatë që plotësojnë kushtet ligjore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela Zonja

